



AGJENCIA PËR MBËSHETJE FINANCIARE NË BUJQËSI DHE ZHVILLIMIN RURAL

Në bazë të nenit 7, alinea 9 të Ligjit për themelimin të Agjencisë për përkrahje financiare në bujqësi dhe zhvillim rural ("Gazeta Zyrtare" e Republikës së Maqedonisë nr. 72/07, 5/09, 43/14, 193/15, 39/16 dhe 164/18), Agjencia për përkrahje financiare në bujqësi dhe zhvillim rural shpall

THIRRJE PUBLIKE nr. 03/2019 për dorëzimin e kërkesave për shfrytëzim të mjeteve nga Programi për mbështetje financiare të zhvillimit rural për vitin 2019

I. LËNDA E SHPALLJES

Lëndë e kësaj shpalljeje është ndarja e mbështetjes financiare për masat në vijim

Grupi i masave	Emri i masës	Mjetet në disponim
Për masën 412	Krijimi i grupeve aksionare lokale (GAL)	1.000.000,00
Për masën 413	Realizim i strategjive për zhvillim lokal të vendeve rurale	13.000.000,00

II. TË DREJTË PËR SHFRYTËZIMIN E MJETEVE

Të drejtë për shfrytëzimin e mjeteve kanë subjektet në vijim:

Subjekte
Mbështetja është e paraparë për Grupin aksionar lokal për zhvillim të rajoneve rurale (GAL) të themeluara sipas nenit 89 të Ligjit për bujqësi dhe zhvillim rural.

III. SHUMA E PËRKRAHJES FINANCIARE

Mbështetja financiare paguhet sipas principit të financimit të aktiviteteve dhe investimeve të përfunduara nga ana e shfrytëzuesit në shumën prej 100% nga vlera e shpenzimeve të pranueshme të miratuara për aktivitetin/investimin nga furnizimi publik i realizuar. Mjetet nga mbështetja financiare me kërkesë të shfrytëzuesit mund të shpërndahen si pagesë paradhënie në shumën prej 40% nga vlera e shpenzimeve të pranueshme të miratuara ose në tërësi pas realizimit të aktiviteteve/investimit e miratuara me planin operativ vjetor për punën e GAL.

Mbështetja financiare maksimale për masën 412 do të jetë e ndarë në mënyrë të barabartë për çdo GAL për të gjitha aktivitetet/shpenzimet e miratuara sipas mjeteve në disponim nga masa.

IV. KUSHTET PËR SHFRYTËZIMIN E MJETEVE DHE DOKUMENTACIONI I CILI DUHET TË DORËZOHET

Kërkesat parashtrihen në kopje origjinale.

Kushtet të cilat duhet të plotësojnë kërkesit e mjeteve janë përcaktuar me:

- Programi për përkrahje financiare të zhvillimit rural për vitin 2019 ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 23/19 dhe 32/19)
- Ligin për bujqësi dhe zhvillim rural ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 49/10, 53/11, 126/12, 15/13, 69/13, 106/13, 177/14, 25/15, 73/15, 88/15, 154/15, 11/16, 53/16, 120/16, 163/16, 74/17 dhe 83/18)
- Rregullores për kriteret më të përafërta për zgjedhje të shfrytëzuesve të masave për zhvillim rural ("Gazeta zyrtare e R. Maqedonisë" nr. 124/11, 80/13, 35/16, 101/17 dhe 162/18) dhe

- Rregullores për kushtet shtesë më të përafërta për mbështetje të masave për zhvillim rural, shpenzimeve të pranueshme dhe shuma e mbështetjes për shpenzimet e pranueshme për shfrytëzues për masë individuale ("Gazeta zyrtare e R. Maqedonisë" nr. 124/11, 80/13, 72/14, 35/16, 59/16 dhe 178/18).

- Të gjitha aktivitetet/investimet duhet të jenë të realizuara sipas Ligjit për furnizime publike të Republikës së Maqedonisë së Veriut

- Kërkesit nuk guxojnë të fillojnë me realizim të investimit para lidhjes së Marrëveshjes për ko-financim me Agjencinë.

V. MARRJA E FORMULAREVE DHE UDHËZIMEVE

Formularët "Kërkesë për mbështetje financiare" së bashku me listën e dokumenteve të nevojshme dhe Udhëzimi për shfrytëzuesit mund të merret në ueb faqen e Agjencisë www.ipardpa.gov.mk.

Formularët e lartpërmendur mund të merren edhe drejtpërdrejtë në Agjenci çdo ditë pune prej ora 8:30 deri në ora 16:30 në adresën:

Agjencia për përkrahje financiare në bujqësi dhe zhvillim rural,
Rr. "3-ta Makedonska Brigada" nr. 20
(ndërtesa e Makedonija Tabak bloku C)
1000 Shkup

VI. MËNYRA E DORËZIMIT TË DOKUMENTEVE

Kërkesat e plotësuara për shfrytëzim të mjeteve nga Programi për përkrahje financiare të zhvillimit rural për vitin 2019 së bashku me tërë dokumentacionin e nevojshëm dorëzohen në gjuhën maqedonase, në zarf të mbyllur në të cilin në anën e parme në këndin e epërm të majtë qëndron shenja "MOS HAP", për Thirrjen publike numër 03/2019 dhe theksim të shifrës së masës/nën-sektorin për të cilën parashtrihet kërkesa. Kërkesa mund të parashtrihet përmes postës me rekomandim ose personalisht në sportelin e Agjencisë, në të kundërtën Agjencia nuk merr përgjegjësi për arrije jo në kohë ose të pakompletuar në sportel ose për hapje të parakohshme të kërkesës

Afati përfundimtar për parashtrim të kërkesës është **18.04.2019**.

Kërkesat e parashtruara pas afatit të paraparë nuk do të shqyrtohen.

Informacione më të hollësishe në kontakt tel. (02) 3097-460 ose në e-mail adresën:

ipardpa.info@ipardpa.gov.mk dhe
ueb-faqen www.ipardpa.gov.mk.

Kontakt:

Agjencia për mbështetje financiare në bujqësi dhe zhvillimin rural,
Sektori për miratim të projekteve
Telefoni 02 3097-460, çdo ditë pune nga ora 08:30 deri 16.00
E-mail: ipardpa.info@ipardpa.gov.mk



AGJENCIA PËR MBËSHETJE FINANCIARE NË BUJQËSI DHE ZHVILLIMIN RURAL